

FJALA E DEPUTETIT VANGJEL DULE

E ENJTE 17 NËNTOR 2022

E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Integrimi është kryefjala e të gjitha debateve që mund të zhvillohen në sallën e këtij parlamenti, që prek fatet e vendit, të shoqërisë, të qytetarëve, jo për pesë apo për pesëdhjetë vjet, por për kohët në vazhdimësi, që lidhet me fatet e vendit dhe të qytetarëve në mënyrë të pazgjidhshme, dhe për rrjedhojë, përgjegjësia, as nuk mundet dhe as nuk duhet të kufizohet në kuadret e ngushta të mandateve qeverisëse. Ne kemi një përvojë të hidhur. Për 8 vjet rresht ishim vend kandidat pa arritur të hapim negociatat.

Kjo përvojë e hidhur (nuk shkoj më tutje me frazeologji sot, se dua të jem konstruktiv), ka përgjegjësi dhe përgjegjësia ka emër dhe mbiemër individual, por edhe të forcave politike. Pas kësaj, a do të reflektojmë? A do të ndryshojmë kurs? A do ta shndërrojmë në një proces gjithëpërfshirës? A do të kemi një program afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, me objektiva konkretë në të 35 kapitujt që jemi të detyruar të negociojmë dhe a do të jenë të publikuara këto projekte, ku çdo qytetar të arrijë të shikojë cili është kontributi i gjithsecilit, kush e kryen detyrën ndaj vendit dhe ndaj qytetarëve dhe kush nuk e kryen? A do të sjellë qeveria përfundimisht një projekt që ta debatojmë, në vend që të presim mocionet nga opozita?

Zonja dhe zotërinj,

Nuk duhet të harrojmë asnjëherë se procesi i negocimit nuk është më si qëmoti, i pakthyesëm, hyrje në një rrugë pa kthim, por është i kthyeshëm. Çfarë do të thotë që është i kthyeshëm? Në qoftë se ne nuk jemi në nivelin e kërkesave, atëherë mund të detyrohemi të kthehemi, të shkojmë aty ku ishim dhe të mos çuditemi në qoftë se do të kemi këtë performancë. Me keqardhje shumë të madhe u diskutua edhe nga presidenca aktuale e Bashkimit Europian. Të mos keqkuptohemi, jo propozimi për vendimmarrje, por thjesht si një nga skenarët e mundshëm. Nëse do të vazhdojë trendi i emigrimit ilegal nga vendi ynë, të rishqyrtohet edhe qarkullimi i lirë i qytetarëve në BE.

Pra, kur ne arrijmë me politikat tona të vëmë në tavolinat e kancelarive diplomatike të Bashkimit European, qoftë edhe teorikisht, diskutimin e kësaj të drejtë të shenjtë për qytetarinë vendit, e kuptoni se me sa përgjegjësi duhet të reagojmë në të gjitha drejtimet dhe sfidat që kemi në çdo sektor? 35 kapituj. A i kemi ne kapacitetet e duhura negociuese? Ju e patë, në vend që procesi të zgjerohej, në vend që forcat politike pjesëmarrëse në këtë proces të vinin duke u shtuar, në një kohë që ekspertiza duhej të përqafohej me më të mirët e të mirëve, brenda dhe jashtë vendit, kjo u kufizua. Edhe një negociator nga radhët e diplomatëve që patëm në krye të punëve, ne e abroguam, për t'ia rikthyer jo figurave partiake, por oborrit të ngushtë.

Zonja dhe zotërinj,

Do të kemi rastin t'u drejtohem të gjitha spektrave një nga një. A kemi ne një demokraci funksionale liberale, e cila mund të mbajë peshën që kërkohet për integrimin e vendit tonë? A kemi ne një shtet të së drejtës, i cili mund t'u përgjigjet sfidave? A kemi ne një pushtet legjislativ funksional? Ne kemi një parti kapanon. Ne kemi një qeveri në formën e një sekretariati teknik. Ne kemi një qeveri, e cila i mësyn opozitës për ta ndarë, përçarë dhe për ta fragmentarizuar. Ne kemi një drejtësi që ende nuk arrin të gjejë ritmin e dhënies së drejtësisë.

Ne kemi një media, e cila jo vetëm është e kapur në një shkallë të konsiderueshme, por në çdo tentativë të saj për të fituar lirinë që i duhet për të kryer misionin e saj, gjendet nën agresionin e partisë-shtet. Jemi ne në situata që pa ndryshuar njësisht konceptimin dhe praktikën tonë të përditshme politike, të mbajmë peshën e integritit të vendit tonë në Bashkimin European? Jo, zotërinj. Nëse nuk ndryshojmë, do të dështojmë.